

20250310730

Në bazë të nenit 25 paragrafi 3 të Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 161/19 dhe 229/20), ministrja e Arsimit dhe e Shkencës, miratoi

PROGRAMIN PËR TRAJNIME DHE PËRKRYERJE PROFESIONALE TË MËSIMDHËNËSVE PËR VITIN 2025

Neni 1

Me këtë program përcaktohen trajnimet për përkryerjen profesionale të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2025.

Neni 2

Trajnimet për përkryerje profesionale të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2025 janë nga fushat, nënfushat dhe temat e mëposhtme të trajnimit:

I. PËR SHKOLLAT FILLORE

1. FUSHA: Njohuri për lëndën mësimore dhe sistemin edukativo - arsimor

Nënfusha: Njohuri për sistemin edukativo-arsimor

Temat:

- Mësimi në distancë: aplikacionet e internetit dhe platformat e të mësuarit,
- Edukimi në kontekstin bashkëkohor: zhvillimi i aftësive socio-emocionale të nxënësit,
- Multikulturalizmi në shkollat njëgjuhëshe dhe shumëgjuhëshe dhe
- Vetëvlerësimi i cilësisë së procesit arsimor në nivel të shkollës.

2. FUSHA: Mësimdhënia dhe të nxënësit

Nënfusha: Planifikimi dhe përgatitja e mësimdhënies

Tema:

- Gjithëpërshirja (inkluzioni) dhe qasjet në mësimdhënien e nxënësve me nevoja/aftësi të veçanta arsimore.

Nënfusha: Realizimi i mësimdhënies

Temat:

- Zbatimi i qasjeve inovative ndërvepruese në mësimdhënie,
- Mësimdhënia e bazuar në qasje të bazuar në problem,
- Të mësuarit përmes kërkimit, punës me projekte dhe zgjidhjes së problemeve,
- Mësimdhënia për zhvillimin e mendimit kritik të nxënësit dhe
- Mësimdhënia që synon arritjen e rezultateve të nxënësit në nivelin më të lartë.
- Njohuritë matematikore – lexim, interpretim dhe zgjidhje të një problemi të caktuar duke organizuar dhe interpretuar informacionin dhe duke zgjedhur një metodë për zgjidhjen dhe
- Shkrim - leximi në shkencat natyrore – njohja e pyetjeve shkencore, përdorimi i njohurive shkencore, identifikimi i përmbajtjes në kërkimin shkencor dhe lidhja e të dhënave shkencore me dëshmi dhe konkluzione.

- Përmirësimi i shkrim – leximit dhe zhvillimi i interesimit për lexim me kuptim të nxënësit përmes metodave për zhvillimin e shkrim – leximit të moshës së hershme, teknikat e leximit me të kuptuarit dhe metodat për përcjelljen dhe evaluimin e përparimit në lexim, me qëllim nxënësit të mësojnë të mendojnë në mënyrë kritike (programi me përparësi) dhe
- Zbatimi i mjeteve digjitale për mësimin interaktiv dhe personal (programi me përparësi).

Nënfusha: Vlerësimi i nxënësve

Temat:

- Dizajnimi i testeve objektive të njohurive.
- Hartimi dhe përdorimi i duhur i instrumenteve të ndryshme të vlerësimit, si dhe ofrimi i reagimeve konstruktive për arritjet e nxënësve dhe
- Aplikimi i teknologjisë digjitale në vlerësimin e nxënësve.

Nënfusha: Njohja e nxënësve dhe plotësimi i nevojave të tyre

Temat:

- Zhvillimi profesional dhe këshillimi në karrierë i nxënësve (mentorimi, ndjekja, qasjet për zbulimin e afiniteteve dhe interesave, motivimi dhe zhvillimi, etj.).
- Aftësi të kufizuara specifike njohëse të të nxënësit dhe
- Njohuri të gjuhës së shenjave për nivelet I, II, III dhe IV.
- Shprehitë e gjelbra: njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet për të menduarit, planifikimi dhe veprimi me empati, përgjegjësi dhe kujdes për planetin tonë (programi me përparësi)

3. FUSHA: Krijimi i një mjedisi stimulues mësimor

Nënfusha: Krijimi i një mjedisi mësimor të sigurt dhe stimulues

Temat:

- Ballafaqimi me dhunën e bashkëmoshatarëve dhe bullizmin kibernetik
- Zgjidhja e konflikteve me nxënësit dhe ndërmjet nxënësve.
- Zhvillimi i parimeve dhe vlerave etike – promovimi i përgjegjësisë sociale të nxënësit,
- Mbështetja dhe promovimi i shëndetit mendor të nxënësve dhe
- Specifikat në periudhat e zhvillimit psikosocial të nxënësve, njohja e sjelljeve të rrezikshme, trajtimi dhe zhvillimi i sjelljes elastike tek nxënësit.

Nënfusha: Krijimi i një klime pozitive në shkollë

Tema:

- Strategjitë e menaxhimit në klasë - parime dhe shembuj të praktikës së mirë për krijimin e një atmosfere pozitive të punës në klasë dhe në klasën virtuale/ online.

4. FUSHA: Gjithëpërfshirja sociale dhe arsimore

-Nënfusha: Gjithëpërfshirja sociale dhe arsimore

Tema:

- Strategjitë, metodat dhe teknikat për të punuar me nxënës të talentuar.

5. FUSHA: Zhvillimi profesional si dhe bashkëpunimi profesional

Nënfusha: Bashkëpunimi profesional

Tema:

- Bashkëpunimi profesional i mësimdhënësve (aktivet profesionale, bashkësitë e të nxënësit, mentorimi, etj.).

II. PËR SHKOLLAT E MESME

1. FUSHA: Mësimdhënia dhe të nxënit

Nënfusha: Zbatimi i mësimdhënies

Temat:

- Qasjet pedagogjike që aktivizojnë nxënësit dhe zhvillojnë kompetencat e tyre kryesore,
- Praktika që përfshijnë aktivizimin kognitiv të nxënësve, si mendimi kritik, zgjidhja e problemeve dhe vlerësimi i informacionit,
- Të menduarit kreativ dhe inovativ - teknika për nxitjen e kreativitetit, qasje inovative në mësimdhënie dhe zhvillimin e aftësisë për të inovuar tek nxënësit dhe
- Të mësuarit nga përvoja: si ta bëjmë çdo lëndë tërheqëse dhe interesante për gjeneratën e re, sfida për të punuar me nxënësit e gjeneratës së re.

Nënfusha: Njohja e nxënësve dhe plotësimi i nevojave të tyre

Temat:

- Zhvillimi profesional dhe këshillimi në karrierë i nxënësve (mentorimi, monitorimi, qasjet për zbulimin e afiniteteve dhe interesave, motivimi dhe zhvillimi, etj.) dhe
- Njohuri të Gjyhës së shenjave për nivelet I, II, III dhe IV.

2. FUSHA: Krijimi i një mjedisi mësimor stimulues

Nënfusha: Krijimi i një mjedisi mësimor të sigurt dhe stimulues

Temat:

- Specifikat në periudhat e zhvillimit psikosocial të nxënësve, njohja e sjelljeve të rrezikshme, trajtimi dhe zhvillimi i sjelljes elastike tek nxënësit dhe
- Motivimi si faktor suksesi në procesin arsimor me elementë të inteligjencës emocionale (empatia, dëgjimi aktiv etj.).

Neni 3

Ky program hyn në fuqi ditën vijuese nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 18-2732/1
10.2.2025
Shkup

Ministre e Arsimit dhe e
Shkencës,
Prof. Dr. **Vesna Janevska**, d.v.